



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 20.07. 2026

VENDIM

Nr. 19 Datë 20 /07 /2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN JASHTË RADHE.

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Mërkurë , më datë 29.07.2026, **ora 12:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 29.06.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 29.06.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për një rishpërndarje në VKB Nr 128 dt 22.12.2025 “Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026”
7. **Projekt – Vendim:** Miratimin e Tavanëve Përfundimtare të Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec.
8. **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026”, I ndryshuar.
9. **Të tjera.**

Ngarkohet Sekretarja e Këshillit , në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale, lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për cdo këshilltar, te kryetari I Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari I Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

